



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 23.03.2023

NJOFTIM PUNËSIMI

Në zbatim të Vendimit nr. 877, datë 14.12.2016, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 719, datë 31.10.2014 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, si dhe në VKM nr. 56, datë 01.02.2023 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023, në njësitë e qeverisjes qendrore”,

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall njoftimin e punësimit për vendet e pa plotësuara si mëposhtë vijon :

I. DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËS

➤ SEKTORI I PROTOKOLL ARKIVËS

SPECIALIST PROTOKOLLI (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë), kategoria IV-b.

➤ Detyrat kryesore:

1. Pranon, evidenton dhe shpërndan korrespondencën zyrtare që vjen në AZHBR si dhe kryen veprimet për nisjen e korrespondencës zyrtare në destinacionin përkatës.
2. Shpërndan dokumentet sipas përcaktimit të titullarit.
3. Hap dosje sipas pasqyrës emërtuese dhe sistemon gjatë gjithë vitit.
4. Sistemon cdo dokument në dosjen përkatëse.
5. Mban, ruan dhe administron vulën e Institucionit.

➤ Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:

1. Diplomë e nivelit “Bachelor” në Shkenca Shoqërore. Diplomat e marra jashtë vendit duhet të njehsohen nga institucionet përgjegjëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit
4. Të kenë njohuri të gjuhës angleze.
5. Preferohet të kenë përvojë pune ose internshipi/praktika profesionale.

➤ Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”;
- Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, të ligjit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 27.03.2023, ora 16.30 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjollesha”, Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.

TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR www.azhbr.gov.al, PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL